



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.07.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.07.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Plus ditamed”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me aparate mjekësore dhe jo mjekësore “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6415-1-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e dt.12.07.2022, e parashtruar nga Operatori Ekonomik “Plus ditamed”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizimi me aparate mjekësore dhe jo mjekësore “ , Nr. i prokurimit- 632-22-6415-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-056-121**, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 28.07.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Anullohet AKTIVITETI I PROKURIMIT , i publikuar me datë: 28.07.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj anulimin e aktivitetit të prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Plus ditamed”, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim me dt.12.07.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me aparate mjekësore dhe jo mjekësore”, Nr. i prokurimit- 632-22-6415-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-056-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Plus ditamed”, të dt.12.07.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë të bazuara, prandaj vendos që të bëj anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

